



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Doretuar Prijmljena/Prodato Received/Delivered	24-06	2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org/Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPM/SHCK	3694/2022		1/4	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.449/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetar, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.449/2022 të datës 12.05.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë rruga

kundër Vendimit me Nr. 111-355/5 të datës 29.04.2022 të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 23.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.449/2022 e datës 12.05.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr. 111-355/5 i datës 29.04.2022 i Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

A r s y e t i m

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, më datë 28.03.2022 ka publikuar njoftimin për shpallje të konkursit me Nr. Reference:RN00008613 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën “Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm”, ku afati për aplikim rrjedh nga data 12.04.2022-19.04.2022. Në këtë konkurs ka aplikuar dhe ankuesja, ndërsa në bazë të Vendimit me Nr. 111-355/2 të datës 21.04.2022 të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal i është refuzuar aplikacioni për shkak që nuk plotëson kriteret e parapara në konkurs për nga kategoria funksionale.

Ankuesja më datë 27.04.2022, kundër Vendimit me Nr. 111-355/2 të datës 21.04.2022 të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, ka parashtruar ankesë me Nr. 111-355/3 të Divizioni i Burimeve Njerëzore. Divizioni i Burimeve Njerëzore përmes udhëheqësit më datë 29.04.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. 111-355/5 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankueses duke e lënë në fuqi vendimin e datës 21.04.2022.



Ankuesja kundër Vendimit me Nr. 111-355/5 të datës 29.04.2022 të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, fizikisht më datë 12.05.2022, ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:2754/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 18.05.2022 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Më datë 25.05.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me Nr. Prot:2754/2022 të datës 12.05.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 111-355/5 të datës 29.04.2022 të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal; Ankesën e ankueses e datës 27.04.2022; Vendimin me Nr. 111-355/2 i datës 21.04.2022 i Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal; Deklarimin vullnetar të ankueses për aplikim në pozitën Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm prill 2022; Emailin e datës 19.04.2022 nga ankuesja; Emailin e datës 19.04.2022 për ankuesen; Konkursin Nr. Reference:RN00008613 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm"; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 27.08.2018 në emër të ankueses; Vendimin e datës 29.03.2018 për emërimin e ankueses Udhëheqëse e Departamentit për Zhvillim të Qëndrueshëm Komunal; Përshkrimin e detyrave të punës të Drejtorit të Departamentit për Zhvillim të Qëndrueshëm Komunal; Diplomën me Nr. 418 e datës 10.12.2002; Diplomën me Nr. 038/14 i datës 10.06.2014; Certifikatën e datës 10.11.2017; Mirënjohje e datës 13.06.2021; Vërtetimin e datës 09.02.2022; Certifikatën e datës 18.01.2022 nga Gjykata Themelore në Prishtinë; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 28.01.2022, 31.12.2020, 23.11.2020; Certifikatën e datës 18.11.2005; Certifikatën e datës 20.07.2009. 23.11.2009; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 18.05.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 25.05.2022; Aplikacionin e kandidatës me dokumentacionet e bashkëngjitura; Aplikacionin e kandidatës me dokumentacionet e bashkëngjitura; Aplikacionin e ankueses së bashku me dokumentacionet e bashkëngjitura; Aplikacionin e kandidatit së bashku me dokumentacionet e bashkëngjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e **pabazuar, sepse:**

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 111-355/5 të datës 29.04.2022 të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, pretendon që ka bërë deklaram vullnetar që të aplikoj në pozitë më të ulët se pozita që mbanë duke marr për bazë disa raste në ministritë e linjës, për faktin që nuk ka asnjë dispozitë ligjore e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, që e ndalon një gjë të tillë, andaj vendimi i ankimuar është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankueses ka analizuar dispozitat e nenit 38 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe nenit 40 të

Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se plotësimi i pozitave të lira në Shërbimin Civil, në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, fillimisht bëhet nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë, e cila procedurë e konkurrimit është e mbyllur dhe në të kanë të drejtë të marrin pjesë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të Shërbimit Civil.

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjegjësisht Vendimin me Nr. 112-333 të datës 29.03.2018, ka gjetur që ankuesja është emëruar në pozitën Udhëheqëse e Departamentit për Zhvillim të Qëndrueshëm Komunal për të cilën më datë 27.08.2018 i është bërë ndryshimi dhe plotësimi i Aktit të Emërimit

Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht neni 33 paragrafi 2, ka bërë klasifikimin e pozitave në shërbimin civil, ku ka përcaktuar se: *"Pozitat në Shërbimin Civil ndahen në këto kategori: 2.1. Kategoria e lartë drejtuese, që përfshin këto pozita: sekretar i përgjithshëm, drejtor ekzekutiv dhe zëvendësdrejtor i një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme; 2.2. Kategoria e mesme drejtuese, që përfshin këto pozita: drejtor i departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.3. Kategoria e ulët drejtuese, që përfshin këto pozita: shefi i divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të; dhe 2.4. Kategoria profesionale, që përfshin zyrtarët profesionalë"*, si rrjedhojë pozita të cilën aktualisht mban ankuesja Udhëheqëse e Departamentit për Zhvillim të Qëndrueshëm Komunal hyn në kuadër të kategorisë së *mesme drejtuese*, ndërsa pozita në të cilën është hapur konkursi "Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm", hyn në kategorinë e *ulët drejtuese*, kjo referuar edhe Rregullores (QRK) Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, e cila në nenin 11 paragrafi 3 ka përcaktuar klasat përbërëse të kategorisë të mesme drejtuese: Drejtor Departamenti në një Ministri, ndërsa neni 12 paragrafi 3 ka përcaktuar klasat përbërëse të kategorisë së ulët drejtuese udhëheqës i divizionit në një ministri, në këtë rast Rregullorja (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ka specifikuar kushtet dhe kërkesat e veçanta për lëvizjen brenda kategorisë përkatësisht me nenin 41 të kësaj rregullore përcaktohet se: *1.Për të aplikuar për lëvizjen brenda kategorisë, duhet të plotësohen së bashku, kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën zhvillohet procedura e konkurrimit. 2 Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për procedurë të lëvizjes brenda kategorisë janë: 2.1. të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon; 2.2. të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale; 2.3. të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; 2.4. të jetë vlerësuar të paktën "mirë" për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit. 2.5. Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit. 3. Kërkesat e veçanta për pozitën e lirë përcaktohen sipas përshkrimit të punës dhe bëhen pjesë e shpalljes për konkurim për lëvizjen brenda kategorisë".*

Andaj në kuptim të dispozitave të nenit 38 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe nenit 40 dhe neni 41 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të këtyre provave konstaton se ankuesja nuk ka mundur të aplikojë për lëvizje në kategori në një pozitë të kategorisë tjetër nga pozita që mban, rrjedhimisht edhe pretendimet ankimore të ankuseses janë të pabazuara, sepse deklarimi vullnetar për aplikim në pozitën Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm nga ankuesja nuk nënkupton të drejtën e saj për të aplikuar në lëvizje brenda kategorisë nga një kategori më e lartë.

Bazuar në të lartcekurat, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Vendimi me Nr. 111-355/5 i datës 29.04.2022 i Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, është nxjerr në pajtim me nenin 33, nenin 38 të Ligjit Nr. 06/LI-114 PËR Zyrtarët Publikë, nenin nenit 40 dhe nenin 41 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, po ashtu ky vendim përmban elementet e aktit administrativ dhe arsyeimi i tij është në pajtim me nenin 47 dhe nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që të gjitha pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.449/2022

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.